



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË GJIROKASTËR

P/V E N D I M



Nr. _____ Datë. _____ 2026

“PËR MIRATIMIN E SISTEMEVE TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”i ndryshuar, ligjin nr. 48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 22/2018 Për Strehimin Social”, konkretisht në nenin 15 bëhen ndryshime, ku pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me përmbajtje si vijon: “1/1. Sistemi i pikëzimit në total duhet të përmbajë 100 pikë, ku çdo kriter i përcaktuar në nenin 16, përmban 25 pikë dhe mënyra e shpërndarjes së pikëve brenda kritereve bëhet vetë nga njësia e vetëqeverisjes vendore VKM nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij” pika 2 dhe 2.1, VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” pika 12, VKM nr. 453 datë 03.07.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”. Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës _____. ____ 2026

VENDOSI:

1. Miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet sociale të strehimit si me poshtë:
 1. Sistemi i pikëzimit për trajtimin sipas programit të Subvencionimit të Qirasë sipas aneksit nr.1 bashkëngjitur.
 2. Sistemi i pikëzimit për trajtimin sipas programit të Subvencionimit të Interesave të Kredive sipas aneksit nr.2 bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Shërbimit Social dhe Shëndetësor
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit të tij.

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

P/VENDIM

NR 40 , DATË 01/06/2026

“Për transferimin e fondeve për projektin “TOUR”

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 01.06.2026 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për transferimin e fondeve për projektin “TOUR”. Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936 (dt.26.06.2008) “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296 datë 8.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për Manancat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 10, datë 12.07.2024 “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe VKB nr.101 datë 22.12.2025 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit vjetor 2026”,

V E N D O S I

1. Të miratojë transferimin e mëposhtëm;

Bëhet:

Gr.00 Tit. AA115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P563AAA “TOUR” në vlerën 1 942 793.09ALL pa TVSH

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj

Sekretari Këshillit

Bexhet Baxhella





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË GJIROKASTËR



P/VENDIM

Nr. ____ Datë. ____ / ____ /2026

**“PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR TË EMERGJENCËS CIVILE
PËR VITIN 2026 PËR MASA PARANDALUESE TË RRËSHQITJES SË SHPATIT TË
MALIT NË FSHATIN “KOLONJË” GJIROKASTËR**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ; të Ligjit Nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”; të Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; VKM Nr.414, datë 08.07.2021 “Për Udhëzimin Nr.09, datë 23.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; VKB Nr.101, datë 22.12.2025 “Për miratimin e PBA 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026”; Proces-Verbalit të Konstatimit dhe Preventivit të datës 26.05.2026 të Bashkisë Gjirokastrë.

Në mbledhjen e datës ____ . ____ .2026, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratoj përdorimin e fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile në shumën **1 584 397.56** (nje million e peseqind e tetedhjetë e kater mije e treqind e nentedhjetë e shtate presje pesedhjetë e gjashtë) lekë me TVSH, Për masa parandaluese të rrëshqitjes së shpatit të malit në fshatin “Kolonjë”.
2. Të miratoj përdorimin e fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile në shumën **43 730** (dyzet e tre mije e shtateqind e tridhjetë) lekë me tvsh për Mbikëqyrje dhe Kolaudim te objektit të mësipërm
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Bexhet Baxhella

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita Isaraj